




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Br.str.	28
Date/Data:	15.01.2020
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE	



Datë: 15.01.2020

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 68, paragrafi 68.3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 16, nenin 17, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, bënë këtë:

NJOFTIM PËR PJESËMARRJE NË DISKUTIM PUBLIK PËR PROJEKT-RREGULLOREN E TRANSPORTIT RRUGOR NË KOMUNËN FUSHË-KOSOVË

Njoftohen qytetarët dhe të gjithë të interesuarit e tjerë, se diskutimi publik për: 'Projekt-Rregulloren e Transportit Rrugor në Komunën e Fushë-Kosovës', është i hapur nga data: 15.01.2020-28.01.2020.

Për sqarime dhe konsultime lidhur me 'Projekt-Rregulloren e Transportit Rrugor në Komunën e Fushë-Kosovës' mund të drejtoheni në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedis, kati i parë, në ndërtesën e Komunës së Fushë-Kosovës, rruga 'Tahir Zemaj'.

Takimi për konsultim publik do të mbahet më datë: **24.01.2020, në orën 11:00h**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në ndërtesën e Komunës.

Njoftimi për diskutim publik publikohet në ueb-faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

Përshëndetje!

Kryetari i Komunës
Burim Berisha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO-POLJE



PROJEKT
RREGULLORE
KOMUNALE PËR TRANSPORTIN RRUGOR NË TERRITORIN E
KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVËS

Fushë-Kosovë, 2019

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja (c) të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 6, paragrafi 5 të Ligjit për Transportin Rrugor Nr. 04/L-179, në nenin 13, paragrafi 13.6 shkronja (c) të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 98 të datës 17.08.2012, Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës në mbledhjen e mbajtur më _____ 2019 miratoi:

PROJEKT- RREGULLORE PËR TRANSPORTIN RRUGOR NË TERRITORIN E KOMUNËS SË FUSHË- KOSOVËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Me këtë Rregullore rregullohet:

- 1.1. Ushtimi i veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave në territorin e komunës së Fushë-Kosovës (më tutje komuna);
- 1.2. Rregullimi ose ndalimi i përdorimit të autobusëve publik në rrugë të caktuara;
- 1.3. Marrja dhe zbritja e udhëtarëve dhe çështjeve tjera lidhur me transportin e udhëtarëve;
- 1.4. Krijimi dhe mbajtja (ruajtja) e regjistrave dhe inspektimi i tyre;
- 1.5. Transporti i bagazhit të udhëtarëve ose mallrave tjera;
- 1.6. Rregullimi ose ndalimi i transportit të udhëtarëve që qëndrojnë në këmbë;
- 1.7. Pajisja, mjetet (të brendshme ose të jashtme) të autobusëve publik;
- 1.8. Pika e stacioneve dhe vend-ndaljet në linjat për autobus.

Neni 2 Fushëveprimi

Rregullimin dhe organizimin e transportit rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave në rrugët publike në territorin e komunës së Fushë-Kosovës e bënë organi kompetent komunal.

Neni 3 Përkufizimet

Termat që vlejné nga Ligji për këtë Rregullore përkufizohen si vijon:

Ministria - nënkupton Ministrinë përkatëse për transport.

Komunë - nënkupton njësinë themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Kosovë.

Organi kompetent komunal – Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit dhe Drejtoria e Inspektoratit.

Operatori transportues - nënkupton personin juridik ose fizik i cili ushtron veprimtarinë e transportit publik i cili posedon licencë.

Rrugë publike - nënkupton auto-udhën, rrugën magjistrale dhe lokale me të drejtë shfrytëzimi nga të gjithë shfrytëzuesit sipas kushteve të përcaktuara.

Auto taksi - nënkupton veprimtarinë e transportit të udhëtarëve që ushtrohet nga personi fizik dhe juridik.

Stacion i autobusëve - nënkupton ndërtesën me sipërfaqe përcjellëse të licencuar nga Ministria që të ofroj shërbime për operatorët e transportit dhe udhëtarëve.

Vend ndalje - nënkupton sipërfaqen e ndërtuar dhe të shënuar, posaçërisht e caktuar për ndaljen e autobusëve e që mundëson hyrjen dhe daljen e sigurt të udhëtarëve dhe bagazheve.

Itinerari - nënkupton aktin i cili e përcakton kahun e lëvizjes së automjetit në linjë.

Lëshues i licencës - nënkupton organin i cili sipas dispozitave të këtij ligji është përgjegjës për lëshimin e licencës.

Certifikatë e automjetit - nënkupton dokumentin të cilin e lëshon organi përgjegjës për çdo automjet veç e veç, dhe i cili përmban të dhënat për: lëshuesin e organit përgjegjës, operatorin e transportit, numrin e licencës, përkatësisht lejes, shenjën (targat) e regjistrimit, markën dhe tipin e automjetit, llojin e transportit që mund të kryhet, datën e lëshimit të certifikatës, vulën dhe nënshkrimin.

Transport publik - nënkupton transportin të cilin në kushte të njëjta mund ta shfrytëzojnë të gjithë shfrytëzuesit e shërbimeve të transportit.

Transport publik linjor i udhëtarëve - nënkupton transportin i cili kryhet në relacionet e caktuara dhe sipas rendit të udhëtimit, çmimeve dhe kushteve të përgjithshme të transportit të përcaktuara paraprakisht.

Licencë - nënkupton aktin me të cilin lejohet ushtrimi i veprimtarisë së transportit rrugor ose të mallrave.

Linjë urbane - nënkupton linjën e cila lidh dy e më tepër stacione, gjegjësisht vend ndalje brenda kufijve urban të një komune.

Linjë udhëtarësh - nënkupton linjën në të cilën kryhet transporti ndërmjet stacionit fillestar dhe përfundimtar, përkatësisht vend ndaljes së autobusëve me ndalje të obligueshme në të gjitha stacionet, përkatësisht vend ndaljet e autobusëve përgjatë rrugës së përcaktuar në rend të udhëtimit.

Operator i transportit - nënkupton personin fizik ose juridik, vendor ose i jashtëm, i cili posedon licencën për kryerjen e veprimtarisë së transportit në komunikacionin rrugor.

Fletudhëtim - nënkupton formularin e përcaktuar të cilin operatori i transportit duhet ta ketë gjatë kryerjes së transportit rrugor të lirë të udhëtarëve në transportin e brendshëm.

Relacion - nënkupton distancën ndërmjet dy vendeve të linjës të cilat në rend të udhëtimit janë shënuar si stacione të autobusëve, përkatësisht si vend ndalje të autobusëve.

Fletëngarkesë - nënkupton aktin i cili shoqëron mallin dhe duhet të përmbajë: datën dhe vendin e lëshimit, emrin dhe mbiemrin ose emërtimin e dërguesit, pastaj adresën e tij, emrin dhe mbiemrin ose emërtimin e operatorit të transportit, shenjën e regjistrimit të automjetit, datën dhe vendin e ngarkimit të mallit, emrin dhe mbiemrin ose emërtimin e marrësit dhe vendin e shkarkimit, shënimin e sasisë dhe të llojit të ngarkesës, listën e dokumenteve që i bashkëngjiten fletëngarkesës, shpenzimet e transportit dhe shpenzimet e tjera.

Rend i udhëtimit i harmonizuar - nënkupton rendin e udhëtimit të vërtetuar i cili ka kaluar procedurën e harmonizimit.

Tarifë - nënkupton aktin i cili përmban çmimin lidhur me kryerjen e shërbimeve dhe kushteve tjera transportuese.

Neni 4

Kompetencat e Komunës në sektorin e transportit

1. Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës me propozim të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Mjedis të Komunës së Fushë-Kosovës:
 - 1.1. Përcakton politikat e zhvillimit të shërbimeve të transportit: të sigurt, efikase dhe ekonomike brenda territorit të komunës;
 - 1.2. Nxjerr Planin e Transportit Lokal dhe e ndryshon atë sipas nevojës;
 - 1.3. Ndryshon Planin e Transportit jo më vonë se 5 vjet nga data e nxjerrjes së tij;
 - 1.4. Plani duhet të jetë në përputhshmëri me politikën e zhvillimit të tërësishëm të transportit në Kosovë;
 - 1.5. Publikon Planin dhe një kopje ia dërgon Ministrisë së Infrastrukturës.

Neni 5

Transporti rrugor i udhëtarëve

1. Transporti rrugor i udhëtarëve në territorin e komunës ushtrohet si:
 - 1.1. Transport urban i rregullt i udhëtarëve me autobusë;
 - 1.2. Transport taksi i udhëtarëve;

- 1.3. Transporti i veçantë i udhëtarëve;
- 1.4 Transporti për nevoja personale.
2. Drejtoria kompetente komunale është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit urban të udhëtarëve me autobusë dhe transportin taksi të udhëtarëve.

Neni 6

Ushtrimi i veprimtarisë së transportit

1. Veprimtaria e transportit rrugor të udhëtareve ushtrohet nga operatorët e licencuar që i plotësojnë kushtet sipas ligjeve në fuqi dhe kësaj rregulloreje.
2. Operatorët e transportit që kryejnë veprimtarinë e transportit në territorin e komunës janë të detyruar:
 - 2.1. Të përdorin mjete të transportit që janë teknikisht në gjendje të rregullt;
 - 2.2. Të mbajnë në mënyrë të rregullt regjistrin dhe dokumentet për çdo automjet për veprimtarinë e vet transportuese;
 - 2.3. Të plotësojnë evidenca statistikore sipas formave të miratuara nga organet përkatëse dhe t'i raportojnë ato sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
 - 2.4. Në automjetet transportuese të mbaj dokumentet përkatëse sipas Ligjit për Transportin Rrugor;
 - 2.5. Operatori i transportit, i cili bënë transportin e rregullt publik, në pajtim me kushtet dhe kapacitetet disponuese të automjeteve duhet të marr përsipër transportin e çdo udhëtari të cilët sipas rregullave të veçanta nuk janë të përjashtuar nga transporti.

Neni 7

Kushtet që duhet të plotësoj operatori për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve dhe mallrave

1. Për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus, operatori duhet t'i plotësoj kushtet si vijon:
 - 1.1. Aplikacioni i cili duhet të përmbajë emrin, selinë, adresën, numrin e telefonit të kompanisë dhe fletëpagesën për aplikim;
 - 1.2. Certifikatën mbi regjistrimin e biznesit në Kosovë;
 - 1.3. Dëshminë që ka në pronësi ose me qira zyrën administrative dhe parkingun;
 - 1.4. Dëshminë e lëshuar nga gjykata se menaxheri i operatorit nuk ka pengesa ligjore të zhvilloj veprimtarinë në lëmin e transportit;
 - 1.5. Dëshminë që menaxheri i operatorit e plotëson kriterin e kompetencës profesionale ose të ketë të punësuar si menaxher një person i cili e plotëson këtë kriter me kontratë minimum një (1) vit;
 - 1.6. Dëshminë që operatori plotëson kriterin e besueshmërisë financiare;
 - 1.7. Dëshmi që operatori ka kryer detyrimet tatimore komunale;
 - 1.8. Dëshmi të lëshuar nga Ministria përkatëse që operatori nuk ka pengesa të natyrës administrative-fiskale për ushtrimin e veprimtarisë (në origjinal);
 - 1.9. Të ketë në pronësi së paku tre (3) autobus të regjistruar dhe të siguruar në Kosovë;
 - 1.10. Certifikatën e kontrollit teknik jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;

- 1.11. Autobusët duhet të jenë të shënuar në të dy anët me mbishkrimin e emrit të firmës (shkronjat në madhësi mbi 25 cm);
- 1.12. Automjeti me të cilin bëhet transporti rrugor i udhëtarëve dhe mallrave në trafikun urban duhet t'i plotësoj kushtet teknike dhe tekniko-shfrytëzuese të rregullsisë së automjeteve.
2. Operatori është i detyruar të ketë në marrëdhënie të rregullt pune menaxherin i cili duhet të posedoj certifikatën për kompetencë profesionale të lëshuar nga Ministria.
3. Certifikata për kompetencë profesionale është e domosdoshme për licencë.
4. Reputacioni i mirë plotësohet nëse menaxheri-personi që menaxhon operatorin nuk ka pengesa ligjore për ushtrimin e veprimtarisë të transportit rrugor.
5. Besueshmëria financiare plotësohet nëse operatori me rastin e aplikimit për licencë në emër të biznesit të tij plotëson njërin nga këto kushte:
 - 5.1. Garanci të lëshuar nga banka ose institucioni i sigurimit në vlerë prej 2000 € për pesë (5) vjet;
 - 5.2. Me rastin e regjistrimit të biznesit posedon kapital në vlerë prej 10.000 €;
 - 5.3. Aktivin tregtar, përfshirë pronat të cilat mund t'i lërë peng si garanci në vlerë prej 10.000€;
 - 5.4. Mjete pune (pajisjet) dhe kapitalin punues në vlerë prej 10.000€.

Neni 8 Certifikata e automjetit

1. Pjesë përbërëse e licencës është certifikata e automjetit, e cila lëshohet nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis. Një autobus nuk mund të ketë më shumë se një certifikatë. Certifikata vlen deri në skadimin e licencës.
2. Certifikata lëshohet vetëm në emër të operatorit të licencuar nga drejtoria kompetente komunale.
3. Në rastet e ndërrimit të pronësisë së autobusit pronari i certifikuar është i obliguar ta kthej certifikatën në drejtorinë komunale jo më larg se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e ndërrimit të pronarit.
4. Me rastin e shitjes së autobusit apo ndërrimit të pronësisë së tij, operatori është i obliguar që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh të plotësojë numrin e autobusëve bazuar në nenin 7 të kësaj Rregullore, në të kundërtën Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis do të inicioj procedurën për revokim të licencës.
5. Certifikatën e autobusit e nënshkruan Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Mjedis.
6. Për të përmbushur standardet teknike të certifikimit operatori duhet të:
 - 6.1. Posedoj mjetet teknike në gjendje të mirë, të cilat duhet t'i plotësojnë standardet teknike dhe të sigurisë në rrugë;
 - 6.2. Autobusët duhet të posedojnë së paku 8 + 2 ulëse - fabrikisht.

Neni 9 Licencimi

1. Veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave kryhet në bazë të licencës.
2. Veprimtarinë e transportit rrugor të rregullt të udhëtarëve dhe transportit të lirë brenda territorit të komunës së Fushë-Kosovës e ushtron operatori transportues i licencuar.

3. Licenca është e domosdoshme për:
 - 3.1. Transportin e rregullt të udhëtarëve,
 - 3.2. Transportin taksi të udhëtarëve,
 - 3.3. Transportin e mallrave dhe
 - 3.4. Terminalet e mallrave.
4. Licenca nuk është e nevojshme për automjetet e ndihmës së shpejtë, të zjarrfikësve etj.
5. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit e lëshon licencën për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Neni 10 **Procedurat për licencim**

1. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet nga personi i autorizuar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, në origjinal ose kopje të vërtetuar.
2. Komisioni i emëruar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit bënë verifikimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga aplikuesi brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e aplikimit.
3. Nëse komisioni konstaton se operatori nuk i ka plotësuar kushtet për licencim dhe nuk e ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm, atëherë mund t'i lejohet një afat prej shtatë (7) ditëve për plotësimin e dokumentacionit.
4. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit brenda një afati jo më të gjatë se tridhjetë (30) ditë nga dita e vlerësimit të komisionit duhet t'i japë përgjigje operatorit nëse kërkesa e tij aprovohet apo refuzohet.

Neni 11 **Lëshimi i licencës**

1. Licencën e lëshon Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit e Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Licenca lëshohet në kohëzgjatje prej pesë (5) vjet.
4. Licenca nuk mund të tjetërsohet nga titullari i saj tek një operator tjetër.
5. Në rast se operatori brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e lëshimit nuk e tërheq licencën do të bëhet anulimi i saj.
6. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit do të mbajë regjistrin dhe një kopje të licencave të operatorëve.

Neni 12 **Vazhdimi i licencës**

Për vazhdimin e licencimit Operatori është i detyruar t'i plotësoj kushtet sipas nenit 14 të Rregullores dhe së bashku me aplikacionin për licencim së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.

Neni 13 **Ndryshimi i licencës**

1. Për të gjitha ndryshimet e bëra nga kushtet dhe kriteret në bazë të cilave operatori ka fituar licencën, duhet të kërkohet pëlqimi nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis.

2. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis në afat prej tridhjetë (30) ditësh do të marr vendim dhe me të njëjtin e informon parashtruesin e kërkesës.

Neni 14 **Pezullimi i licencës**

1. Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Mjedis mund ta pezullojë licencën në rastet kur:
 - 1.1. Kjo kërkohej me vendim të gjykatës, deri në marrjen e vendimi përfundimtar,
 - 1.2. Kur Drejtoria e Inspektoratit vlerëson se ka shkelje të legjislacionit në fuqi, të cilat e rregullojnë sferën e transportit rrugor,
2. Inicimin e procedurës për pezullimin e licencës e bën inspektori i komunikacionit nëpërmes Drejtorisë së Inspektoratit të cilën ia drejton Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Mjedis.
3. Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Mjedis brenda afatit prej tri (3) ditësh emëron komisionin i cili e shqyrton propozimin e Drejtorisë së Inspektoratit.
4. Nëse vërtetohet se kërkesa e Drejtorisë së Inspektoratit është e bazuar dhe vërtetohet se operatori është përgjegjës, komisioni i propozon drejtorisë përkatëse për pezullim të licencës.
5. Pezullimi zgjat deri në verifikimin dhe vendimin përfundimtar.

Neni 15 **Refuzimi i kërkesës për licencim**

1. Kërkesa për marrjen e licencës refuzohet kur:
 - 1.1. Nuk i plotëson kriteret dhe kushtet e përcaktuara për licencim të parapara në nenin 14 të kësaj Rregulloreje.
 - 1.2. Ka paraqitur informacione jo të vërteta në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës.
 - 1.3. Kërkon të përtërij licencën dhe nuk i plotëson kushtet për ripërtëritje të saj.

Neni 16 **Pavlefshmëria dhe zëvendësimi i licencës**

1. Licenca është e pavlefshme kur:
 - 1.1. Vdes ose humb zotësinë për të vepruar poseduesi i saj;
 - 1.2. Falimenton ose likuidohet operatori;
 - 1.3. Ka përfunduar afati i vlefshmërisë;
 - 1.4. Janë bërë të palexueshme ose mungojnë të dhënat si:
 - 1.4.1. Emri i operatorit dhe adresa e selisë,
 - 1.4.2. Nënshkrimi i autoritetit përgjegjës dhe vula përkatëse,
 - 1.4.3. Data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë.
2. Zëvendësimi i licencës bëhet me kërkesë të operatorit për rastet kur deklarohet e humbur, e vjedhur, e shkatërruar, ose ka humbur vlefshmërinë sipas nën-paragrafit 1.4 të këtij neni.
3. Operatori që kërkon zëvendësimin e licencës sipas paragrafit 2 të këtij neni dhe ndryshon emrin apo të dhënat tjera të vërtetuar me vendim gjykatë, certifikatë të biznesit dhe certifikatë tatimore i jepet

një autorizim i përkohshëm me afat një (1) muaj për vazhdimin e veprimtarisë deri në kryerjen e verifikimit të nevojshëm.

4. Pas kryerjes së verifikimit, lëshohet licenca zëvendësuese me të njëjtën përmbajtje, por me numër tjetër të identifikimit duke arkivuar licencën e vjetër, kundrejt tarifës 50% të vlerës së përgjithshme.

Neni 17

Revokimi i licencës

1. Licenca revokohet në rast kur:

- 1.1. Operatori nuk i plotëson kriteret për licencim të përcaktuara në nenin 8 të Rregullores;
- 1.2. Operatori që nuk e plotëson kriterin e besueshmërisë financiare, atij i jepet deri në dy (2) muaj kohë për plotësim;
- 1.3. Operatori që nuk plotëson kriterin e kompetencës profesionale, atij i jepet deri në dy (2) muaj kohë, për zëvendësimin dhe emërimin e personave të tjerë;
- 1.4. Poseduesi i licencës nuk respekton legjislacionin në fuqi që rregullojnë sferën e transportit rrugor;
- 1.5. Operatori e transferon licencën tek një operator tjetër;
- 1.6. Dëshmohet se operatori ka paraqitur informacion jo të saktë ose ka falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës;
- 1.7. Propozimin për iniciimin e procedurës për revokimin e licencës e bën inspektori i komunikacionit rrugor përmes Drejtorit të Drejtorisë së Inspektoratit;
- 1.8. Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Mjedis e emëron komisionin i cili do të shqyrtoj propozimin dhe do të vlerësojë nëse propozimi për iniciim të procedurës për revokim të licencës është i bazuar dhe do t'i propozojë Drejtorit për marrjen e vendimit për revokimin e licencës apo hedhjen poshtë të propozimit të Drejtorisë së Inspektoratit.

Neni 18

Detyrimet e operatorit të licencuar

1. Të veproj në pajtim me ligjet, aktet nënligjore dhe dispozitat e kësaj rregulloreje të cilat e rregullojnë sferën e transportit rrugor;
2. Operatori gjatë kryerjes së transportit në autobus duhet të ketë licencën në original ose kopje të vërtetuar;
3. Dëshminë e kualifikimit për drejtuesin e automjetit;
4. Në mjetet e transportit të udhëtarëve (autobus) të ketë të rezervuara se paku dy (2) vende të veçanta për personat me nevoja të veçanta;
5. Orarin e udhëtimit, çmimorën dhe mbishkrimin mbi ndalimin e pirjes së duhanit, e cila duhet të jetë e vendosur në vend të dukshëm në automjet;
6. Automjeti duhet të plotësojë kushtet tekniko-sanitare-higjienike dhe tekniko-eksploatuese.
7. Operatori transportues është i obliguar që transportin të kryejë në mënyrë të rregullt dhe sipas rendit të udhëtimit të vërtetuar dhe të regjistruar.

8. Operatori transportues obligohet që të fillojë veprimtarinë e transportit të rregullt urban të udhëtarëve në afat prej 3 ditësh nga dita e fuqizimit të rendit të udhëtimit dhe atë nuk mund ta ndërpres derisa zgjat afati i rendit të udhëtimit.
9. Përjashtimisht nga paragrafi 8 i këtij neni, operatori transportues mund përkohësisht të ndërpres veprimtarinë si rezultat i kushteve të jashtëzakonshme të cilat pamundësojnë ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt urban.
10. Për ndërprerjen nga paragrafi 9 i këtij neni, operatori transportues është i obliguar që të informojë organin përgjegjës komunal, i cili do të lëshojë vendim për pranim apo refuzim të kërkesës së operatorit transportues.
11. Operatori i transportit rrugor është i detyruar t'i paraqesë inspektorit tërë dokumentacionin e kërkuar dhe t'i krijojë atij të gjitha lehtësitë për ushtrimin e kompetencave sipas ligjit dhe rregullores.
12. Për çdo ndryshim të dhënave në bazë të cilave është lëshuar licenca duhet të lajmëroj Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Mjedis;
13. Të përgatisë raporte vjetore për kryerjen e veprimtarisë të cilat duhet të dorëzohen në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Mjedis dhe duhet të ruhen më së paku pesë (5) vjet

Neni 19 **Rendi i Udhëtimit**

1. Rendi i udhëtimit është akt me të cilin përcaktohen elementet për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt në transportin rrugor, në territorin e komunës, i cili përmban:
 - 1.1. Emrin e transportuesit,
 - 1.2. Relacionin,
 - 1.3. Llojin e transportit,
 - 1.4. Radhitjen e vend-ndaljeve dhe largësinë e tyre nga pika fillestare,
 - 1.5. Kohën e nisjes dhe kohën e arritjes në çdo stacion dhe vend-ndalje,
 - 1.6. Periudha kohore në të cilën mbahet linja,
 - 1.7. Afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit.
2. Rendi i udhëtimit vlen 2 (dy) vite.
3. Rendi i udhëtimit nuk mund të tjetërsohet e as të jepet me qira.
4. Transferimin e rendit të udhëtimit e bënë vetëm Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis.
5. Emri i operatorit transportues të shënuar në rendin e udhëtimit duhet të jetë i njëjtë me atë të shënuar në librezën e qarkullimit të autobusit dhe dokumenteve tjera përcjellëse të autobusit.
6. Rendet e udhëtimit lëshohen nga organi përgjegjës komunal.

Neni 20 **Revokimi i rendit të udhëtimit**

1. Rendi i udhëtimit do të revokohet nga organi që e ka lëshuar atë në rastet kur:
 - 1.1. Në afat prej tri (3) ditësh nga dita e fuqizimit nuk ia fillon veprimtarisë,
 - 1.2. Brenda një muaji kalendarik pa miratimin e organit që e ka lëshuar atë nuk i përmbahet rendit të udhëtimit tri herë radhazi,
 - 1.3. Kur operatori vepron në kundërshtim me ligj, aktet nënligjore dhe këtë rregullore.

2. Propozimin për iniciimin e procedurës për revokimin e rendit të udhëtimit e bënë Inspektorit i Komunikacionit;
3. Vendimi merret nga organi që e ka vërtetuar atë pas dëshmisë së provave dhe argumentimit nga inspektorët e komunikacionit rrugor pranë Komunës.

Neni 21 **Çmimorja**

1. Transportuesit e paraqesin çmimoren pranë organit kompetent komunal për vërtetimin e çmimit. Çmimoren e miraton Drejtori i Drejtorisë për Shërbimeve Publike dhe Mjedis, në bazë të kompetencave ligjore, përmes komisionit të veçantë të formuar nga drejtoria. Çmimorja duhet të vendoset në autobusin që qarkullon në atë linjë.
2. Personeli i autobusit merr pagesën për shërbime vetëm në bazë të çmimoreve, me kuponë fiskal të cekur në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Çdo udhëtar në autobus duhet të pajiset me biletë në përjashtim të fëmijëve deri në moshën 7 vjeçare të cilët janë të liruar nga pagesa. Bileta blihet në autobus apo vende të tjera përkatëse, tek të cilat transportuesi ia ka besuar shitjen e tyre.

Neni 22 **Transporti i veçantë**

1. Transporti i veçantë i udhëtarëve është transporti i grupeve të caktuara të udhëtarëve, duke përjashtuar udhëtarët tjerë në relacionin e caktuar dhe në bazë të lejes së veçantë.
2. Me transport të veçantë të udhëtarëve kryhet transporti i:
 - 2.1. Nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme nga vendbanimi deri te shkolla dhe anasjelltas;
 - 2.2. Punëtorëve nga vendbanimi deri në punë dhe anasjelltas.
3. Lejet për transport të veçantë lëshohen në bazë të kontratës e cila duhet të ketë:
 - 3.1. Relacionin;
 - 3.2. Listën e udhëtarëve;
 - 3.3. Çmimin e transportit, vendet për marrje dhe zbritje të udhëtarëve;
 - 3.4. Kohën gjatë së cilës kryhet transporti.
4. Kontratën e bënë operatori transportues, i licencuar nga Komuna-Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis dhe porositësi i shërbimeve për grupin e udhëtarëve, ku porositësi është njëkohësisht edhe paguesi i transportit.
5. Lejen për transport të veçantë sipas këtij neni e lëshon organi kompetent komunal.
6. Leja për transport të veçantë nuk përmban rend të udhëtimit dhe çmimoren.
7. Në autobus në pjesën e përparme, në vend të dukshëm duhet të jetë mbishkrimi 'Transport i veçantë'.

Neni 23 **Transporti për nevoja personale**

1. Operatori transportues, personi tjetër juridik ose fizik, i cili ka automjetin transportues, mund të kryej transport për nevoja vetanake, si: transportin e punëtorëve të vet ose personave tjerë që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimtarisë së vet dhe transportin e anëtarëve të familjes kur shkojnë në pushim apo rekreacion.

2. Transport i udhëtarëve për nevoja personale në kuptimin e kësaj Rregulloreje konsiderohet edhe transport i personave të cilët kryejnë:
 - 2.1. Personat juridik dhe fizik të cilët kryejnë veprimtaritë hoteliere,
 - 2.2. Agjencitë turistike, personat tjerë juridik dhe fizik të cilët kryejnë veprimtari turistike ku në bazë të kontratës së veçantë të transportit, transportojnë grupe turistësh pa pranimin dhe zbritjen e udhëtarëve gjatë rrugës,
 - 2.3. Shoqatat kulturore, sportive dhe shoqatat tjera që transportojnë nxënës, student, personel arsimor ose anëtarët e vet,
 - 2.4. Auto-shkollat të cilat aftësojnë kandidatët për vozitës gjatë punës së tyre,
 - 2.5. Operatorët transportues ose punëtorët të cilët kryejnë shërbime të veçanta,
 - 2.6. Operatorët për shërbime të aeroportit ose shoqatat tjera të shërbimeve të aeroportit nëse kryejnë transportin e udhëtarëve nga vendnisja e tyre e deri tek aeroporti dhe anasjelltas.
3. Veprimtaria e transportit për nevoja personale i nënshtrohet marrjes së një autorizimi/certifikate të lëshuar nga ministria respektivisht komuna, varësisht nga kompetencat që ushtrojnë në bazë të ligjit dhe akteve nënligjore.
4. Në autobusin me të cilin kryhet transporti për nevoja personale, duhet të jetë plotësuar regjistri i punëtorëve ose i personave tjerë, i vërtetuar nga pronari (transportuesi);
5. Në këndin e djathtë, të poshtëm, të xhamit mbrojtës të autobusit me të cilin kryhet transporti i udhëtarëve për nevoja personale, vendoset mbishkrimi “Transport për nevoja personale”.

Neni 24 **Kushtet për automjet**

1. Të gjithë autobusët me të cilët kryhet transporti publik urban i udhëtarëve, duhet të jenë të regjistruar dhe teknikisht në rregull, sipas dispozitave ligjore.
2. Autobusi me të cilin kryhet transporti publik urban, duhet të ketë:
 - 2.1. Firmën, respektivisht emërtimin e transportuesit, në pjesën anësore;
 - 2.2. Numrin e linjës me kohën e nisjes dhe kohën e arritjes, ose intervalin e lëvizjes në stacionin e fundit, të vënë në këndin e poshtëm të djathtë të xhamit mbrojtës.
 - 2.3. Orarin e udhëtimit dhe çmimoren e transportit, të vendosura në vend të dukshëm dhe mbishkrimin për ndalimin e pirjes së duhanit.
3. Autobusi duhet t’i plotësojë të gjitha kushtet higjieno-teknike, të përcaktuara me ligj.
4. Kur autobusi nuk bën transportin e rregullt të udhëtarëve, në këndin e majtë të xhamit mbrojtës vihet mbishkrimi përkatës “Garazh” apo “Defekt”.
5. Gjatë sezonit të dimrit, para fillimit të punës në linjën e caktuar, autobusi duhet të ngrohet.

Neni 25 **Linjat e transportit**

1. Transporti i rregullt i udhëtarëve me autobusë kryhet në relacione të caktuara (linja) sipas rendit të udhëtimit të përcaktuar dhe të vërtetuar më parë, çmimit të caktuar e të shpallur dhe kushteve të tjera të transportit.
2. Linjat të cilat lidhin dy e më tepër vendbanime në territorin e komunës, janë linja komunale.

3. Kuvendi i Komunës, me propozim të Drejtorisë, miraton rrjetin e linjave urbane dhe numrin e orareve në to.
4. Komuna mund të lidhë marrëveshje për linja me komunat tjera për rregullimin reciprok të transportit të udhëtarëve. Marrëveshja për linjat është e plotfuqishme pasi të miratohet nga Ministria e Infrastrukturës.

Neni 26 **Përcaktimi i linjave**

1. Në trafikun linjor transporti publik urban i udhëtarëve kryhet me linja të përhershme, për çdo ditë dhe gjatë tërë vitit apo në periudhë të caktuar të vitit.
2. Linjat e transportit publik urban të udhëtarëve caktohen me Planin e Transportit Lokal.

Neni 27 **Vend-ndaljet**

1. Hyrja dhe dalja e udhëtarëve behët vetëm në stacionet e autobusëve dhe në vend-ndaljet e destinuara dhe të regjistruara në rendin e udhëtimit.
2. Transportuesi është i obliguar të ndalet në të gjitha vend-ndaljet, të cilat i ka të regjistruara në rendin e udhëtimit.
3. Operatori nuk guxon të ndalet jashtë vend-ndaljeve që nuk janë të regjistruara në rendin e udhëtimit.
4. Vend-ndaljet e autobusëve në linjat e përhershme me plan i cakton Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis.
5. Drejtoria e cakton numrin e vend-ndaljeve që janë të destinuara për kryerjen e shërbimeve të transportit urban.
6. Vend-ndaljet në linjat urbane periferike duhet të jenë të rregulluara dhe të shënuara, duhet të kenë sipërfaqe të trafikut për ndaljen e automjetit, sipërfaqen për hyrjen dhe daljen e udhëtarëve dhe shenjat e stacionit.
7. Në rrugët publike sipërfaqja për ndaljen e automjetit gjithsesi duhet të jetë e ndërtuar jashtë shiritit të rrugës në pjesë të ndarë.
8. Sipërfaqja e cila shfrytëzohet për hyrjen dhe daljen e udhëtarëve nga automjeti në rrugë apo vendbanim duhet të jetë e shtruar me pllaka ose e betonuar.
9. Për rregullimin e vend-ndaljeve, mirëmbajtjen dhe vendosjen e shenjave kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis.
10. Drejtoria mund të bëjë shkëputjen ose transferin e stacionit dhe vend-ndaljes nëse kjo është në interes të organizimit më të mirë dhe të sigurisë në trafik.
11. Vend-ndalja në linjat në të cilat intervali i qarkullimit është më i gjatë se 15 minuta duhet të posedoj nënpullazet me standarde bashkëkohorë.

Neni 28 **Siguria e Automjeteve dhe Udhëtarëve**

1. Çdo automjet në transportin rrugor të udhëtarëve në trafikun urban duhet të jetë i pajisur me aparat zjarrfikës funksional, barnatore manuale dhe të ketë çekan për thyerjen e xhamave.

2. Në pjesën e brendshme të automjeteve duhet të vendosen mbishkrimet e rëndësishme për rendin në automjet, ulëset për kategoritë e veçanta të udhëtarëve, shenjat e dyerve të hyrjes dhe daljes.
3. Autobusi duhet të jetë me dyshe me ulët i përshtatshëm për persona me nevoja të veçanta (dyert të pajisen me zile për të verbër).
4. Ndalohet vendosja e fotove me karakter pornografik në autobus.
5. Sinjalin për nisjen dhe ndaljen e automjetit e jep personeli i automjetit.
6. Vetëm personeli i automjetit i hap dhe i mbyllë dyert e automjetit.
7. Personeli i automjetit nuk guxon të jep shenjë për nisje derisa të konstatojë se janë mbyllur dyert për hyrje dhe dalje të udhëtarëve.
8. Drejtuesi i automjetit në transportin linjor të udhëtarëve nuk mund të ndalë-parkoj automjetin më gjatë se 10 minuta në stacionin e nisjes.
9. Derisa automjeti është në lëvizje, dyert duhet të jenë patjetër të mbyllura.

Neni 29 **Mirësjellja e Personelit**

Personeli i automjetit ka për detyrë që gjatë orarit të punës të mbajë rrobat (uniformën) zyrtare dhe ndaj udhëtarëve të ketë sjellje korrekte.

Neni 30 **Hyrje-daljet**

1. Udhëtarët hyjnë në automjet në dyert e shënuara për hyrje dhe zbresin në dyert e shënuara për dalje.
2. Personat me aftësi të kufizuara fizike, gratë shtatzëna, personat me fëmijë deri 5 vjeç, inspektorët e trafikut, policët në uniformë dhe personat me autorizime të veçanta mund të hyjnë në dyert e daljes.

Neni 31 **Kontrolla**

1. Për shfrytëzimin e shërbimeve të transportit, udhëtari duhet të ketë biletën e udhëtimit, biletë parapagimi apo leje valide të udhëtimit.
2. Udhëtari është i obliguar që me kërkesën e personit të autorizuar të tregojë biletën përkatëse të udhëtimit.
3. Operatori transportues në trafikun urban është i obliguar që të jap biletën e udhëtimit në bazë të së cilës udhëtari fiton të drejtën për udhëtim.

Neni 32 **Transporti i mallrave**

1. Automjeti me të cilin bëhet transporti rrugor i mallrave në trafikun urban periferik duhet t'i plotësojë kushtet teknike dhe tekniko-shfrytëzuese të rregullsisë së automjeteve.
2. Automjetet për transportin e mallrave duhet të kenë urdhëresë-udhëtimi të nënshkruar dhe të plotësuar në mënyrë të rregullt.

Neni 33 Ndalesat

1. Ndalohet të pengohet personi zyrtar në kryerjen e detyrës,
2. Ndalohet pirja e duhanit në automjet,
3. Ndalohet futja e kafshëve në automjet,
4. Ndalohet hyrja në automjet me armë,
5. Ndalohet futja në automjet e sendeve të cilat mund të lëndojnë, dëmtojnë, ndotin, shqetësojnë udhëtarët,
6. Ndalohet futja në automjet e materialeve ndezëse dhe e mjeteve eksplozive,
7. Ndalohet hyrja në automjet në gjendje të dehur dhe të droguar,
8. Ndalohet shqetësimi i udhëtarëve me këndim, me britmë, me shprehje e sjellje të papranueshme.

Neni 34 Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrjen në transportin rrugor urban dhe transportin taksi brenda territorit të komunës së Fushë-Kosovës e bënë Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, Drejtoria e Inspektoratit përmes inspektorit të komunikacionit dhe Policia e Kosovës.
2. Gjatë ushtrimit të detyrës inspektori i transportit rrugor është i autorizuar si vijon:
 - 2.1. Inspektimin dhe kontrollimin e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve, mallrave, stacioneve të autobusëve dhe terminaleve të mallrave a janë duke e ushtruar veprimtarinë e vet në pajtim me dispozitat e Ligjit, akteve nënligjore dhe kësaj rregulloreje;
 - 2.2. Inspekton dhe kontrollon të gjitha automjetet dhe ekuipazhin e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, objektet tjera afariste, dokumentacionin dhe evidencat që i takojnë transportit rrugor;
 - 2.3. Të ndalojë përkohësisht:
 - 2.3.1. Kryerjen e transportit nëse operatori apo personi fizik i cili kryen transportin për nevoja vetjake nuk përmbush kushtet e përcaktuara për kryerjen e transportit në qarkullimin rrugor;
 - 2.3.2. Shfrytëzimin e automjetit, nëse nuk plotëson kushtet teknike-eksploatuese, teknike-sanitare dhe higjienike;
 - 2.3.3. Drejtimin e automjetit nëse drejtuesi i automjetit nuk posedon patentë – shoferin e kategorisë përkatëse;
 - 2.3.4. Ofrimin e shërbimeve të stacionit, nëse stacioni i autobusëve apo terminali i mallrave nuk i përmbush kushtet e përcaktuara me ligj, akte nënligjore dhe më këtë rregullore;
 - 2.3.5. Transportin e rregullt të udhëtarëve, nëse operatori transportues i huaj nuk kryen transportin në pajtim me këtë ligj, aktet nënligjore dhe më këtë rregullore.
 - 2.4. Të përjashtojnë automjetin nga qarkullimi deri në dyzetetë (48) orë në qoftë se:
 - 2.4.1. Konstaton se operatori është duke kryer transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave në kundërshtim me ligjet në fuqi, aktet nënligjore dhe më këtë rregullore;
 - 2.4.2. Nëse nuk plotëson kushtet teknike-eksploatuese, teknike-sanitare dhe higjienike;
 - 2.4.3. Në qoftë se konstaton se operatori është duke kryer transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave me automjet të pa regjistruar.

- 2.5. Në qoftë se inspektori i shqipton masën e dënimit të njëjtë operator për herë të dytë për shkaqet e përcaktuara nga nën-paragrafi 2.4. i këtij neni automjeti do të përjashtohet nga qarkullimi në kohëzgjatje deri në pesë (5) ditë;
- 2.6. Me rastin e përjashtimit të automjetit auto taksi, merret shenja taksi dhe leja përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë;
- 2.7. Kur inspektori përjashton automjetin nga qarkullimi, merr vendim që automjeti i ndaluar të dërgohet në shpenzime të mbajtësit të licencës në vende të caktuara, nëse është e domosdoshme lidhur me këtë mund të kërkohet ndihma e Policisë së Kosovës;
- 2.8. Të urdhërojë operatorin për eliminimin e parregullsive në transportin rrugor të udhëtarëve, mallrave, stacioneve të autobusëve dhe terminaleve të mallrave;
- 2.9. Të fillojë iniciimin e procedurës për revokimin e licencës, lejes, rendit të udhëtimit, certifikatës së automjetit, certifikatës së shoferit (CPC), certifikatën e menaxherit(CPC);
- 2.10. Të fillojë iniciimin e procedurës pranë gjykatës kompetente kur konstaton se operatori i transportit rrugor të udhëtarëve, mallrave, stacioneve të autobusëve dhe terminaleve të mallrave ka bërë shkelje të dispozitave të ligjit, akteve nënligjore dhe kësaj rregulloreje;
- 2.11. Të nxjerrë vendim për :
 - 2.11.1. Ndalimin e përkohshëm sipas nën-paragrafit 2.3. të këtij neni;
 - 2.11.2. Përjashtimin e automjetit nga qarkullimi sipas nën-paragrafit 2.4. të këtij neni;
 - 2.11.3. Për eliminimin e parregullsive sipas nën-paragrafit 2.5. të këtij neni.
- 2.12. Inspektori i komunikacionit në mënyrë periodike gjatë tërë vitit kalendarik bënë verifikimin e kushteve të licencës së operatorëve të transportit rrugor, terminaleve të mallrave po ashtu verifikimin e kushteve të lejes si dhe rendeve të udhëtimit.
3. Kur inspektori përjashton automjetin nga qarkullimi, merr vendim që automjeti i ndaluar të dërgohet me shpenzime të mbajtësit të licencës, në vend të caktuar për këto raste.

DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 35 Gjobat

1. Me gjobë prej 100 deri 1000 € do të dënohet operatori transportues për kundërvajtje në qoftë se :
 - 1.1. Ushtron veprimtarinë e transportit publik pa licencë (Neni 9);
 - 1.2. Ushtron veprimtarinë e transportit publik të udhëtarëve pa rend të udhëtimit (neni 19, 20);
2. Nëse operatori i transportit përkatësisht personi tjetër juridik apo fizik bënë përsëritje të kundërvajtjes së njëjtë përveç dënimit me gjobë sipas paragrafit 1 të këtij neni do t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalesës së ushtrimit të veprimtarisë në kohëzgjatje prej 6 deri 12 muaj.

Neni 36

1. Me gjobë prej 100 deri në 300 € dënohet operatori transportues nëse:
 - 1.1. Nuk posedon certifikatën e automjetit - Neni 8;
 - 1.2. Nuk mban linjën sipas rendit të udhëtimit të vërtetuar dhe të regjistruar - Neni 20;
 - 1.3. Ndryshon rendin e udhëtimit, ndërpret përkohësisht transportin dhe nuk e paraqet ndërprerjen - Neni

21;

1.4. Nëse nuk paraqet çmimoren dhe nuk e vendos atë në autobus apo nuk i përmbahet asaj - Neni 22 paragrafi 1;

1.5. Bënë transportin e veçantë të udhëtarëve në kundërshtim me Nenin 23;

1.6. Bënë transportin për nevoja personale në kundërshtim me Nenin 24;

2. Për kundërvajtje të njëjta që transportuesi, përkatësisht personi juridik apo fizik i përsëritë, përveç dënimit me gjobë, sipas paragrafit 1 të këtij neni do t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalesës së ushtrimit të veprimtarisë së transportit në kohëzgjatje prej 6 deri 12 muaj.

Neni 37

1. Me gjobë prej 50 deri 100 € do të dënohet personi përgjegjës i operatorit transportues:

1.1. Nëse personelit të vozitjes nuk ia siguron rrobat (uniformën) zyrtare - Neni 30.

Neni 38

1. Me gjobë prej 100 deri 200 € do të dënohet për kundërvajtje operatori transportues:

1.1. Nëse nuk vepron sipas nenit 22 paragrafi 2;

1.2. Nëse nuk vepron sipas nenit 9;

1.3. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 25;

1.4. Nëse nuk vepron sipas nenit 28;

1.5. Nëse nuk vepron sipas nenit 29;

1.6. Nëse nuk vepron sipas nenit 32.

2. Me gjobë prej 50 deri 100 € do të dënohet personi përgjegjës i operatorit transportues:

2.1. Nëse nuk vepron sipas nenit 33;

2.2. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 23;

2.3. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 24.

Neni 39

Dënimet mandatore për kundërvajtje i shqipton inspektori i komunikacionit.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 40

Harmonizimi i planeve më këtë rregullore

1. Obligohet Komuna që në afat prej 6 muajve prej ditës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje të nxjerrë Planin Lokal Rrugor për Transport.

2. Obligohen operatorët që në afat prej 6 muajsh prej ditës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të bëjnë harmonizimin e planeve dhe dokumenteve të tyre në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 41
Shfuqizimi

Me aprovimin e kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Transportin Rrugorë në Territorin e Komunës së Fushë-Kosovës me Nr.160 të datës 30.09.2013.

Neni 42
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pune pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb –faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

KUVENDI I KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVËS

Nr. _____ dt. _____ 2019.

KRYESUESJA E KUVENDIT

Vjollca Tërnavë-Konjusha